



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P.501/2017

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Leonard Gremshi	Zv/Kryetar
Hektor Balluku	Anëtar
Kleves Janku	Anëtar
Odise Moçka	Anëtar

Në mbledhjen e datës 06.07.2017 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimin e vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “Trinity Trade Company” shpk nga procedura e prokurimit “*Kërkesë për propozime*”, me Nr.REF-08719-04-25-2017, me objekt “Loti I Blerje mobiljesh për Sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak Berat”, me fond limit 3.078.000, zhvilluar më datë 05.05.2017, nga autoriteti kontraktor Bashkia Berat.

Ankimues: “Trinity Trade Company” shpk
Rr. “Reshit Collaku”, Nd.38 (pall.15 katësh) , H.6,
ap.3, Njësia Administrative nr.10, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Berat
Lagjia “Iliria”, Berat.

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë, 29.12.2014 “*Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010, “*Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, i ndryshuar.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, pretendimet e tij dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky operator i ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit. nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, me të njëjtin objekt, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës të operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 26.04.2017 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me Nr. REF-72900-03-20-2017 me objekt “*Sinjalistikë vertikale për lidhjen e Unazës së Vogël me Unazën e Mesme të Tiranës*”, me fond limit 24,430,149 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 19.04.2017 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tiranë.

II.2. Në datën 05.05.2017 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

II.3. Në datën 10.05.2017 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezultoi si më poshtë vijon:

- Trinity Trade Company 2.216.000 lekë I skualifikuar

- Ro-Al	2.431.500 lekë	I skualifikuar
- Bolt	2.443.000 lekë	I skualifikuar
- Erald	2.750.500 lekë	I kualifikuar
- Shaga	2.856.544 lekë	I skualifikuar

II.4. Në datën 10.05.2017 operatori ekonomik “Trinity Trade Company” shpk, është njoftuar për skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi për arsyet si më poshtë vijon:

• *Bilanci 2014, 2015, 2016 nuk është i shoqëruar me raport auditimi nga ekspert kontabël i licencuar.*

II.4.1. Në datën 12.05.2017 operatori ekonomik “Trinity Trade Company” shpk., ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kundërshtuar arsyet e skualifikimit të tij të dhëna nga autoriteti kontraktor. Konkretisht ankimesi në ankesën e tij pretendon si më poshtë:

“AK- Bashkia Berat, me date 05.05.2017, ka zhvilluar tenderin e hapur me objekt prokurimi: "Blerje mobiljesh dhe aparatura per Sallen e mbledhjes se Keshillit Bashkiak", LOTI I "Blerje mobilje per sallen e mbledhjeve te Keshillit Bashkiak", me fond limit: 3.078.000 (tre milion e shtatedhjet e tete mije) leke pa tvsh.

Shoqeria Trinity Trade Company, me perroje ne kete fushe, ka marre pjese ne kete gare, duke derguar Oferten e saj dhe dokumentat shoqeruese, nepermjet SPE, sipas kerkesave te DT dhe LPP dhe VKM- se per RRPP.

Me date 10.05.2017, nepermjet SPE, na vijne mesazhet e KVO- se, nepermjet te cileve njoftohemi per klasifikimin e Ofertuesve, ku shohim qe Oferta e shoqerise tone eshte refuzuar, si dhe njoftohemi per arsyen e refuzimit, qe sipas KVO-se perkatese eshte vetem nje si vijon: "Bilanci 2014, 2015, 2016 nuk eshte i shoqeruar me raport auditimi nga eksperti kontabel i miratuar"

Ne si kompani Ofertuese, duke qene te bindur ne Oferten tone e cila eshte e plote dhe e sakte me te gjitha dokumentat shoqeruese te saj, te cilet jane ne perputhje me DT dhe Ligjin, nuk jemi dakord me vleresimin e KVO-se dhe e kundërshtojme ate me kete ankesë drejtuar Titullarit te AK, si me poshte vijon:

Per sa i perket arsyes se Skualifikimit: "Bilanci 2014, 2015, 2016 nuk eshte i shoqeruar me raport auditimi nga eksperti kontabel i miratuar "

Sqarojme:

Ne nenin 41, pika c (personat juridike qe detyrohen per auditim ligjor te pasqyrave financiare) te Ligjit Nr. 10091, date 05.03.2009, PER AUDITIMIN LIGJOR i ndryshuar, thuhet: "Detyrohen te kryejne auditimin ligjor te pasqyrave financiare vjetore perpara publikimit te tyre, nga eksperte kontabel ose shoqeri audituese c) shoqerite me pergjegjesi te kufizuar, te ci/at zbatojne per raportimin financiar standartet kombetare te kontabilitetit, kur ne mbyllje te periudhes kontabe/, tejka/ojne dy prej tre treguesve te meposhtem: i) totali I aktiveve te bilancit, ne mbyllje te periudhes kontabel perkatese, arrin ose e kalon shumen prej

50 milion lekesh; ii) shuma e te ardhurave te bilancit, arrin ose e katon shumen prej 100 milion lekesh; iii) ka, mesatarisht 30 te punesuar gjate periudhes kontabel.

Bazuar ne percaktimet Ligjore te siperpermendura, nje shoqeri e cila e ka detyrim te kryeje raport te auditimit te pasqyrave financiare, duhet ta beje nje gje te tille, perpara se te beje publikimin e tyre , dmth perpara dorezimit prane Autoriteteve perkatese tatimore.

Sqarojme se Autoritetet perkatese Tatimore, kane pranuar dhe konfirmuar te Pasqyrat Financiare te shoqerise per vitet: 2014,2015,2016. Ato nuk mund t'i pranonin dhe konfirmonin ato, nqs nuk do te ishin konform ligjit , apo do te duheshin Raporte te Auditit.

Bazuar ne Nenin 46, pika 1.c te LPP i ndryshuar, ne rastin e shoqerise tone, paraqitja e raporteve te Auditit te Bilanceve 2014,2015,2016, eshte nje informacion i pamundur sepse nuk ekziston nje informacion i tille, pra shoqeria jone nuk ka kryer raporte te auditit per bilancet e viteve te lartpermendur.

Shoqeria Trinity Trade Company, nuk ka kryer raporte te auditit per bilancet e viteve te lartpermendur, sepse nuk e ka detyrim ligjor nje veprim te tille.

Bazuar ne Ne nenin 41, pika c (persona tjuridike qe detyrohen per auditim ligjor te pasqyrave financiare) te Ligjit Nr. 10091, date 05.03.2009 “Per Auditimin Ligjor”, shoqeria trinity trade company, nuk tejkalon dy prej treguesve qe percakton Ligji i siperpermendur, dmth, konkretisht:

i) Po te shikoni me kujdes pasqyrat financiare te paraqitura, Totali I Aktiveve te shoqerise tone per vitet perkatese eshte: viti 2014-22599519.341eke, viti 2015-20937108,031eke, viti 2016 - 22230642.29 leke. Pra sic duket qarte, ne asnje vit financiar, Totali I Aktiveve te shoqerise, nuk e tejkalon vleren e parashikuar ne ligj, 50 milion leke.

ii) Po te shikoni, Vertetimin perkates leshuar nga Autoritetet Tatimore, shuma e te ardhurave te bilanceve (xhiroja vjetore) te viteve 2014,2015,2016, ne asnje vit nuk arrin vleren 100 milion Ieke.

iii) Mesatarja e punonjesve te shoqerise TRINITY TRADE COMPANY per vitet perkatese eshte: viti 2014-6 punonjes, viti 2015-6 punonjes, viti 2016-6 punonjes. Pra sic duket qarte, ne asnje vit financiar, shoqeria nuk arrin apo kalon numrin 30 te punonjesve.

Rrjedhimisht, bazuar ne faktet e mesiperme, shoqeria Trinity Trade Company, nuk tejkalon dy prej treguesve qe percakton Ligji, pra nuk eshte e detyruar te kryeje raporte Auditimi te Pasqyrave Financiare per vitet: 2014,2015,2016.

I kujtojme Titullarit se, per AK, eshte e rendesishme qe OE pjesemarres, me dokumentacionin e paraqitur, te krijojne bindjen tek AK, qe mund te realizojne kontraten dhe te dorezojne mallra sipas kerkesave dhe sipas specifikimeve teknike te dt.

Me dokumentacionin e paraqitur, shoqeria Trinity Trade Company, rezulton qe eshte e afte te realizoje kontraten sipas kerkesave teAK dhe te specifikimeve teknike te mallrave, per rrjedhoje dokumentacioni i paraqitur nga shoqeria jone Trinity Trade Company eshte i plote dhe i vlefshem”.

II.5. Në datën 15.05.2017, me shkresën nr. 2239/1 prot, operatori ekonomik ankimues “Trinity Trade Company” shpk është vënë në dijeni në lidhje refuzimin e ankesës nga ana e autoritetit kontraktor.

II.6. Në datën 22.05.2017 operatori ekonomik ankimues “Trinity Trade Company” shpk ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt ankese drejtuar autoritetit kontraktor.

II.7. Nëpërmjet shkresës nr.2491/1 prot, datë 26.05.2017 protokolluar me tonën me numër 973/2, datë 29.05.2017 është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Trinity Trade Company” sh.p.k për kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij me arsyetimin se “*Bilanci 2014, 2015, 2016 nuk është i shoqëruar me raport auditimi nga ekspert kontabël i licencuar*”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në Shtojcën 7 “*Kriteret e Veçanta të Kualifikimit*” pika 2.2 “*Kapaciteti ekonomik dhe financiar*”, nën-pika 2.2.1 të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

”2.2.1 *Bilanc i vitit 2014, 2015, 2016 i konfirmuar nga autoritetet perkatese (organi tatimor) dhe te shoqeruar me raport auditimi nga ekspert kontabel i licensuar*”.

III.1.2. Nga verifikimet e kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike (S.P.E.) për plotësimin e kriterit të mësipërm, operatori ekonomik ankimues “Trinity Trade Company” sh.p.k ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- *Pasqyrat Financiare për Vitin 2016 të certifikuara nga organet tatimore;*
- *Pasqyrat Financiare për Vitin 2015 të certifikuara nga organet tatimore;*
- *Pasqyrat Financiare për Vitin 2014 të certifikuara nga organet tatimore.*

III.1.3. Në ligjin 10091 datë 05.03.2009 “*Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar*” neni 41 të ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

“*Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare*”

Detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese:

a) të gjitha shoqëritë tregtare, pavarësisht nga forma e tyre, të cilat zbatojnë standardet ndërkombëtare të raportimit financiar;

b) të gjitha shoqëritë aksionare, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit;

c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël.

III.1.4. Në nenin 46, pika 1 gërma “c” e ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se “ [...] Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: c) gjendja ekonomike e financiare: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet ekonomike e financiare për të përmbushur kontratën, me anë të deklaratave bankare ose, kur nevojitet, nëpërmjet vërtetimit për sigurim ndaj rreziqeve profesionale, paraqitjes së bilanceve financiare ose të pjesëve të shkëputura nga bilancet, një deklaratë të xhiros së përgjithshme të shoqërisë dhe, në rast nevojë, të xhiros së realizuar nga veprimtaritë e ngjashme me objektin e kontratës që do të prokurohet për një periudhë deri në 3 vitet e fundit financiare, kur ky informacion është i mundur. [...]”

III.1.5. Neni 53 pika 3 e Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet shprehimisht se: *Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji.*

III.1.6. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e

përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.1.7. Sa më sipër Komisioni konstaton se në kriterin e vecantë të kualifikimit autoriteti kontraktor ka kërkuar nga operatorët ekonomikë pjesmarrës të paraqesin bilanc i vitit 2014, 2015, 2016 i konfirmuar nga autoritetet perkatëse (organi tatimor) dhe të shoqeruar me raport auditimi nga ekspert kontabel i licensuar. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga ankimuesi Komisioni konstaton se janë dorëzuar pasqyrat financiare për vitet 2014, 2015, 2016 të certifikuara nga organet tatimore me vlerë, të pashoqëruara me Raportin e Audituesit të Pavarur.

III.1.8. Referuar bazës ligjore të sipërcituar dhe shqyrtimit të pasqyrave financiare të ankimuesit për vitet 2014, 2015 dhe 2016, rezulton se ankimuesi nuk i nënshtrohet procesit të auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese, duke qenë se së pari nuk përmbush vlerën që parashikon ligji për auditimin e pasqyrave financiare për këto vite, për totalin e aktiveve të bilancit. Akoma më tej Komisioni pas shqyrtimit në tërësi të dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues, lidhur me mosplotësimin e kushteve kumulative që ligji parashikon për shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, konstaton se shoqëria “Trinity Trade Company” shpk, referuar vërtetimit nr.5272/2 datë 15.02.2017 të lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Tatimpaguesit të Mëdhenj ka raportuar të ardhura nga shitja e mallrave/shërbimeve nën vlerën që parashikon ligji për auditimin e pasqyrave financiare, si më poshtë:

- për vitin 2014, shumën prej 20.115.926 lekë;
- për vitin 2015, shumën prej 45.332.910 lekë;
- për vitin 2016, shumën prej 24.663.675 lekë.

Ndërsa referuar vërtetimit Nr.5272 Prot, datë 15.02.2017, lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Tatimpaguesit të Mëdhenj, rezulton se shoqëria “Trinity Trade Company”shpk, nuk ka detyrime në kontribute shoqërore dhe shëndetsore; por nuk është e mundur të vërtetohet numri i punonjësve/fuqi mesatare vjetore për vitet 2014, 2015 dhe 2016, duke qenë se ankimuesi nuk e ka paraqitur vërtetimin përkatës.

Në këto kushte, duke qenë se nuk plotësohen 2 nga treguesit matës të vendosur nga legjislacioni në fuqi, për kryerjen e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore për vitet 2014, 2015 dhe 2016, përpara publikimit të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese; Komisioni gjykon se mosdorëzimi i raportit të auditimit të kërkuar në kriterin e vecantë të kualifikimit nga operatori ekonomik “Trinity Trade Company” shpk, nuk përbën shkak për skualifikimin e tij.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Trinity Trade Company” shpk qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 28 të VKM-së nr. 184, datë 17.03.2010 “Për

miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Trinity Trade Company” shpk për procedurën e prokurimit “*Kërkesë për propozime*”, me Nr.REF-08719-04-25-2017, me objekt “Loti I Blerje mobiljesh për Sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak Berat”, me fond limit 3.078.000, zhvilluar më datë 05.05.2017, nga autoriteti kontraktor Bashkia Berat.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “Trinity Trade Company” shpk duke e kualifikuar këtë operator.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
5. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomike “Trinity Trade Company” shpk.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
7. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr.973 Protokoli, Datë 22.05.2017

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Zv/Kryetar
Leonard Gremshi

Anëtar
Hektor Balluku

Anëtar
Kleves Janku

Anëtar
Odise Moçka

Kryetar
Evis Shurdha